



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 6 (827704)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 5 Shkurt 2021

Zhvillohet sesioni i 185-të i Komitetit Ushtarak të NATO-s



Gjeneralmajor Begaj: FA është e angazhuar në misionet, operacionet dhe aktivitetet e Aleancës

Shefat e Shtabeve të vendeve të Aleancës u "mblodhën" virtualisht ditën e mërkurë, më 27 janar 2021, në sesionin e 185-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s, në nivel shefash shtabi të përgjithshëm të vendeve anëtare të NATO-s. Takimi u hap nga z.Jens Stoltenberg, sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, ndërsa seancat

u drejtuan nga Air Chief Marshal Sir Stuart Peach, kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s, mbështetur nga komandanti Suprem i Forcave Aleate në Europë (SACEUR), gjeneral Tod Wolters dhe komandanti Suprem i Aleancës për Transformimin (SACT), gjeneral André Lanata. "NATO duhet..."

» faqe 2

Ministri Peleshi priti gjeneralin amerikan Joseph F. Jarrard

Në Shqipëri do zhvillohet një nga stërvitjet më të mëdha të ushtrisë amerikane në Evropë

Stërvitja "Defender Europe 21" do të zhvillohet në bazat kryesore ushtarake të vendit tonë gjatë muajit maj të këtij viti, ku do të marrin pjesë rreth 6000 trupa dhe qindra mjete ushtarake nga SHBA, Shqipëria dhe vendeve të tjera aleate » faqe 3



Ministri Peleshi në Bazën Ajrore të Kuçovës

Punimet nisin në vjeshtë dhe zgjasin deri në vitin 2023



» faqe 3

"Resolute Support Mission"

Kontingjenti ushtarak niset me mision në Herat të Afganistanit

Një tjetër kontingjent i Policisë Ushtarake është nisur më 31 janar 2021, me mision në Camp Arena në Herat të Afganistanit. Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi iu ka uruar ushtarakëve mision të mbarë, ndërsa theksoi se Shqipëria mbetet e vendosur për të përbushur detyrimet e saj ndaj Aleancës. "Kontingjenti i radhës që sapo përcollëm do të zëvendësojë kolegët e tyre..."



» faqe 5

Do të fillojnë investimet e NATO-s

Investimi i NATO-s largon turqit nga Baza Ajrore Kuçovë

Në Bazën Ajrore Kuçovë në praninë e komandantit të bazës, major Arqile Ollashi dhe atashut ushtarak të Republikës së Turqisë në vendin tonë, kolonel Muhammet Kelami Kablay si dhe oficerit koordinator të palës Turke në Bazën Ajrore Kuçovë e stafeve respective u zhvillua, më 30 janar 2021, ceremonia e mbarimit të misionit të palës Turke nga Baza Ajrore Kuçovë...

» faqe 5

DEKLARATA

NATO mbështet marrëveshjen për zgjatjen e Traktatit "New START"

» faqe 8

NË POLIGONIN KOMBËTAR TË BIZËS

Zhvillohet stërvitja komplekse 72 orëshe e kursit të XVII-të "Komando"

» faqe 5

TRAGJEDIA E STËRVITJES DIMËRORE TË 6 SHKURTIT 1981

Dëshmorët e Fekenit dhe orteku i malit të Meçekut

» faqe 14-15



Zhvillohet sesioni i 185-të i Komitetit Ushtarak të NATO-s

Gjeneralmajor Begaj: FA është e angazhuar në misionet, operacionet dhe aktivitetet e Aleancës

Komiteti Ushtarak i NATO-s në nivel shefash shtabi të përgjithshëm mbledhet dy herë në vit në Shtabin e NATO-s në Bruksel

Shefat e Shtabeve të vendeve të Aleancës u “mblodhën” virtualisht ditën e mërkurë, më 27 janar 2021, në sesionin e 185-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s, në nivel shefash shtabi të përgjithshëm të vendeve anëtare të NATO-s. Takimi u hap nga z. Jens Stoltenberg, sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, ndërsa seancat u drejtuan nga Air Chief Marshal Sir Stuart Peach, kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s, mbështetur nga komandanti Suprem i Forcave Aleate në Europë (SACEUR), gjeneral Tod Wolters dhe komandanti Suprem i Aleancës për Transformimin (SACT), gjeneral André Lanata.

“NATO duhet të qëndrojë e përgatitur me qëllim përballimin e sfidave, të cilat rrjedhin nga një ambient sigurie i paparashikueshëm në shkallë botërore dhe konkurrues midis vendeve”-theksoi z. Stoltenberg. Gjithashtu, sekretari i Përgjithshëm i NATO-s vlerësoi rolin e Forcave të Armatosura për mënjanimin e transformimit të krizës shëndetësore në një krizë të sigurisë globale. COVID-19 nga ana tjetër nuk i ka eliminuar sfidat e sigurisë që Aleanca dhe vendet anëtare janë duke u përballur, ndaj roli i NATO mbetet i rëndësishëm në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në zonën euroatlantike e më gjerë.

Gjatë axhendës njëditore, shefat e shtabeve të përgjithshëm të vendeve të NATO-s diskutuan për një sërë çështjesh që lidhen me angazhimet operacionale aktuale të NATO-s: misioni “Resolute Support” në Afganistan; misionin e NATO-s në Irak, misionin e KFOR-it në Kosovë, për konceptin e Shkurajimit dhe Mbrojtjes të hapësirës euroatlantike, konceptin e luftimit “CAPSTONE”, planeve në përgjigje të krizës shëndetësore të krijuar nga pandemia COVID-19. Njëzëri të gjithë shefat rikonfirmuan qëndrimin e vendeve anëtare për vijueshmërinë e mbështetjes për misionet dhe operacionet në bazë të vendimmarrjeve politike.

Gjeneralmajor Begaj rikonfirmoi vijimin e kontributeve të Shqipërisë në misionet, operacionet dhe aktivitetet e Aleancës. Në veçanti vlerësoi misionin e NATO-s në Kosovë si suksesin më të madh të NATO, që prej krijimit të saj, në fushën e operacioneve. Komiteti Ushtarak i NATO-s në nivel shefash shtabi të përgjithshëm mbledhet dy herë në vit në Shtabin e NATO-s në Bruksel dhe, një takim me rotacion, një herë në vit në një nga vendet anëtare të Aleancës. Takimi i radhës do të jetë në Greqi, në shtator 2021.



Ministri Peleshi në Dajç: Familjet e dëmtuara do të mbështeten

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi ishte të enjten që kaloi në Dajç të Shkodrës, ku si shkak i prurjeve të shumta ka pasur një çarje të pazakontë të argjinaturës, e cila rrezikonte përmbajtjen e banesave përreth. Pasi u njoh me situatën nga afër, ministri i Mbrojtjes u shpreh se “koordinimi i menjëhershëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me strukturat e tjera qendrore dhe vendore ka mundur fillimin e punës për riparimin e argjinaturës. Në këto momente që flasim është bllokuar kalimi i ujit e po punohet për forcimin e plotë të pjesës së dëmtuar. Sot është dita kur banorët e Shkodrës duan punëjo llafe, nuk është politika ajo që ndal ujin, por puna!”- u shpreh zoti Peleshi.

Në prani të banorëve dhe të kryetares së Bashkisë së Shkodrës, ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi bëri të ditur se në rast se fondet e pushtetit vendor nuk do të mjaftojnë për përballimin e situatës së krijuar nga përmbajtjet, atëherë do të vihet në dispozicion sipas ligjit mbështetja e qeverisë qendrore. “Kjo nuk është çështje kush e ka topin. Kjo kërkon vetëm bashkëpunim. Sapo të kalojmë situatën e përmbajtjeve, pushteti vendor, i lutem Voltanës dhe të gjitha bashkive të tjera të bëjnë vlerësimin e dëmeve”, -u shpreh ministri i



Mbrojtjes, ndërsa dha mesazhin se të gjitha familjet e dëmtuara do të mbështeten. Në bashkinë e Shkodrës, Forcat e Armatosura janë të angazhuara që prej 4 javësh, kryesisht me transportin e banorëve në

fshatin Obot me mjete të larta dhe mjete lundruese. Gjithashtu, efektivet e Batalionit të I-rë të Këmbësorisë në Vaun e Dejës kanë ndihmuar edhe në evakuimin e gjësë së gjallë.

Ministri Peleshi priti gjeneralin amerikan Joseph F. Jarrard

Në Shqipëri do zhvillohet një nga stërvitjet më të mëdha të ushtrisë amerikane në Evropë

Stërvitja "Defender Europe 21" do të zhvillohet në bazat kryesore ushtarake të vendit tonë gjatë muajit maj të këtij viti, ku do të marrin pjesë rreth 6000 trupa dhe qindra mjete ushtarake nga SHBA, Shqipëria dhe vendeve të tjera aleate

Shqipëria dhe Forcat e Armatosura vijojnë përgatitjet për të mikpritur "Defender Europe 21", një nga stërvitjet më të mëdha të ushtrisë amerikane në Evropë. Për të parë nga afër përgatitjet, vendin tonë e vizitoi zëvendëskomandanti i Ushtrisë amerikane në Evropë dhe Afrikë, gjeneralmajor Joseph F. Jarrard, i cili u prit ditën e mërkurë, më 3 shkurt 2021, në një takim nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi.

Ministri Peleshi e njohu gjeneralmajor Jarrard me përgatitjet e deritanishme që vendi ynë ka ndërmarrë dhe e siguroi atë për gatishmërinë e të gjitha strukturave të shtetit shqiptar, me qëllim realizimin me sukses të stërvitjes "Defender Europe 21".

"Ministria e Mbrojtjes, ka gjetur mbështetjen e plotë dhe të pakushtëzuar të të gjitha strukturave të shtetit shqiptar, me qëllim realizimin me sukses të stërvitjes "Defender Europe 21". Personeli ushtarak shqiptar prej muajsh tashmë është angazhuar në identifikimin, ndjekjen dhe zbatimin në terren të çdo detyrimi që na lind nga kjo stërvitje." - u shpreh zoti Peleshi, i cili tha se gjatë stërvitjes do të respektohen protokollet më të mira shëndetësore dhe të gjitha rekomandimet e Organizatës Botërore Shëndetësore, për parandalimin dhe përhapjen e virusit "COVID 19".

Gjithashtu, ministri Peleshi e konsideroi zhvillimin e stërvitjes në vendin tonë si një shenjë e qartë e besimit të SHBA ndaj popullit shqiptar. "Angazhimi për zhvillimin me sukses të kësaj stërvitjeje në territorin tonë është jo vetëm një angazhim ushtarak dhe politik por edhe një moment i rëndësishëm për qytetarët e këtij vendi. Shqipëria si vend aleat në NATO, ndihet e nderuar dhe shumë e vlerësuar për faktin se i është besuar detyra e vendit mikpritës për një nga stërvitjet më të mëdha ushtarake të SHBA në Ballkan dhe në Evropën



Veriore e Qendrore. Kjo stërvitje është jo vetëm një mundësi e rrallë për të përjetuar sfidën profesionale që mbart për Forcat tona të Armatosura, por sigurisht është mbi të gjitha, një akt besimi dhe vlerësimi për vendin tonë." - theksoi ndër të tjera ministri i Mbrojtjes. Stërvitja "Defender Europe 21" ku do të marrin pjesë rreth

6000 trupa dhe qindra mjete ushtarake nga SHBA, Shqipëria dhe vendeve të tjera aleate, do të zhvillohet në bazat kryesore ushtarake të vendit tonë gjatë muajit maj të këtij viti. Stërvitja me trupa "Defender Europe 21" drejtohet nga Komanda e Ushtrisë Amerikane në Evropë. Në këtë stërvitje do të marrin pjesë trupa nga 26 vende aleate.

Ndërkohë zhvillimi i Stërvitjes "Defender Europe 21", ka bërë që Presidenti i Republikës, njëkosisht Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura Ilir Meta ka mbledhur, në të njëjtën ditë, pra ditën e mërkurë, më 3 shkurt 2021, Këshillin e Sigurisë Kombëtare. Në këtë takim morën pjesë

Presidenti i Republikës, njëkosisht Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura Ilir Meta, Kryeministri Edi Rama, zëvendëskomandanti i Ushtrisë amerikane në Evropë dhe Afrikë, gjeneralmajor Joseph F. Jarrard, Ambasadorja e SHBA në Tiranë Yuri Kim, Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme Olta Xhaçka, Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjeneralmajor Bajram Begaj, etj.

"NATO dhe partneriteti strategjik me SHBA janë shumë të rëndësishme për Shqipërinë dhe Ballkanin. Besimi i popullit shqiptar dhe mbështetja ndaj tyre janë unanime, ashtu sikundër edhe vokacioni evropian i Shqiptarëve", tha z. Ilir Meta, Presidenti i Republikës, njëkosisht Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura. Qëllimi i këtij takimi, ishte koordinimi i masave paraprake, me objektivin e qartë, që faza përmblylëse e kësaj stërvitjeje të madhe të realizohet me sukses të plotë.

MINISTRI PELESHI NË BAZËN AJRORE TË KUÇOVËS

Punimet nisin në vjeshtë dhe zgjasin deri në vitin 2023

Baza Ajrore e Kuçovës krijon një infrastrukturë dhe kapacitete të modernizuara në hartën e Aleancës sonë, por rrit edhe peshën strategjike të vendit tonë në rajon dhe më gjerë



me kontraktorët. Ka shumë të interesuar, kontraktorë vendas dhe të huaj, që do të operojnë për të zbatuar projektet. Në planin tonë kalendarik të punimeve në këtë bazë parashikohet nga muaji tetor-nëntor të nisnin punimet që do të zgjasin deri në fund të vitit 2023." - u shpreh ministri Peleshi.



Investimi prej rreth 50 milionë euro, ku 5 milionë euro prej të cilave janë nga buxheti i shtetit shqiptar, konsiston në ndërtimin e depove të armatimit dhe të karburantit, stacioneve të armatimit, parkingut të avionëve, stacionit kundër avarive dhe zjarreve, rindërtimin e pistës dhe kullës së kontrollit.

Punimet për rindërtimin e Bazës Ajrore të Kuçovës pritet të nisin në muajin tetor të këtij viti. Lajmin e dha ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili u njoh më 2 shkurt 2021, me infrastrukturën aktuale të kësaj baze dhe planin për investimin e NATO-s.

I shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj dhe zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj, ministri Peleshi vizitoi bazën dhe pa nga afër mjediset ku do të ndërhyhet, për ta shndërruar Bazën Ajrore të Kuçovës, në bazën e vetme taktike të dislokueshme të NATO-s në rajon.

Ministri Peleshi e cilësoi investimin në këtë bazë si jashtëzakonisht të rëndësishëm për vendin tonë dhe bëri të ditur se punimet në terren do të nisin brenda vitit. "Është një projekt shumë i rëndësishëm në mos më i rëndësishmi i këtyre viteve të fundit, sepse, jo vetëm që na jep një infrastrukturë dhe kapacitete të modernizuara në hartën e Aleancës sonë, por rrit edhe peshën strategjike të vendit tonë në rajon dhe më gjerë. Jemi të gjithë të angazhuar dhe në kohë me kalendarin tonë, si me shpronësimet si me ato pjesë të punimeve që i kemi marrë përsipër t'i kryejmë, që nga rrethimi i bazës, rrugët e brendshme, furnizimi me energji elektrike dhe ujë, të cilat janë pjesë e investimit të palës sonë. Kontributi i palës shqiptare shkon në rreth 10% të vlerës së përgjithshme të investimit në këtë bazë, e cila me investimin e NATO-s do të kthehet në një bazë taktike të dislokueshme.

Punimet synohet të nisin në vjeshtë të këtij viti dhe tani jemi në fazën e procedurave të prokurimit nga Agjencia e Prokurimit e NATO-s. Në fund të marsit pritet të lidhen kontratat

Policia Ushtarake kremton 29 vjetorin e formimit të saj

E përkushtuar në strukturat e FA-së, por edhe në misionet e Aleancës

Çdoherë, më datë 1 shkurt kujtohet me respekt trimëria, karakteri, shpirti i sakrificës dhe devotshmëria e efektivëve të Policisë Ushtarake

Këtë vit Policia Ushtarake festoi 29 vjetorin e krijimit të saj. Më datë 1 shkurt të çdo viti, nga efektivët e PU-së përkujtohet kjo ditë. Tashmë PU është një nga strukturat më të rëndësishme dhe e specializuara në përbërje të Forcave të Armatosura. Në shkurt të 1992 u krijua Dega e Policisë Ushtarake në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura si dhe Rajonet e Policisë Ushtarake pranë komandave të Divizioneve. Fillimisht Policia Ushtarake përbëhej nga Sektori i Disiplinës dhe ai i Qarkullimit Rrugor. Ajo do të aktivizohej për të ruajtur rregullin e disiplinës ushtarake në garnizone, poligone e fushime stërvitore, në qendrat e banuara, si dhe rregullimin e kontrollin e transportit ushtarak.

Në vitin 1993 në strukturën e Policisë Ushtarake u krijua dhe Inspektorati i Mbrojtjes ndaj Zjarrit dhe Shpëtimit i cili kryen veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin. Më pas në fund të vitit 1994 u krijua sektori i Policisë Kriminale, që kishte për mision zbulimin, parandalimin dhe ndërprerjen e veprimtarisë kriminale, evidentimin dhe kapjen e personave që kryejnë krime në Forcat e Armatosura. Plotësimet e vazhdueshme ligjore sollën gradualisht përmirësime në strukturën dhe misionin e Policisë Ushtarake. Kështu në janar të vitit 1995 u krijua Drejtoria e Policisë Ushtarake në përbërje të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, drejtori e cila tashmë planifikonte, drejtonte dhe ndiqte gjithë aktivitetin e Policisë Ushtarake. Edhe sot pas 29 vitesh kujtohet me respekt trimëria, karakteri, shpirti i sakrificës devotshmëria e efektivëve të Policisë Ushtarake, që në emër të nderit, detyrës dhe atdhedashurisë u angazhuan në kryerjen e detyrave në mbrojtje të jetës së njerëzve, pasurive ushtarake dhe objekteve të rëndësishme shtetërore, sa herë që e kërkonte situata. Rikonstruktimi dhe reformimi i vazhdueshëm i Policisë Ushtarake është bërë me mbështetjen e vazhdueshme të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Aktiviteti i Policisë Ushtarake është i gjerë dhe ka treguar se me kapacitetet operacionale, zotëron profesionalizëm gjithmonë në rritje, disiplinën e lartë dhe përkushtimin maksimal me të cilin përmbush me sukses detyrat e saj ligjore, duke siguruar zbatimin e rendit ushtarak dhe zbatimin e ligjshmërisë në FA.

Veprimtaria e Policisë Ushtarake ushtrohet mbi të gjitha subjektet ushtarake e civile, vendase dhe të huaja, me ose pa shtetësi, të cilët, me veprimet e tyre, cenojnë veprimtarinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Policia Ushtarake e ushtron juridiksionin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në përmbushje të ushtrimit të juridiksionit territorial janë organizuar dhe funksionojnë Seksionet e Policisë Ushtarake në rrethe me përhapje, në Kukës, Shkodër, Elbasan, Durrës, Berat, Vlorë, Burrel, Gjirokastrë dhe Korçë.

Policia Ushtarake bashkëpunon sipas nevojës me institucione të tjera,



siç është Policia e Shtetit, në periudhën e vështirë që po kalojmë për shkak të pandemisë Covid-19. Në faqen zyrtare të Forcave të Armatosura do të shkruanin se: “Policia Ushtarake do të bashkëpunonte me Policinë e Shtetit, në qarqet kryesore të Republikës së Shqipërisë, për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të Covid-19. Shërbimi është kryer në harkun kohor të 24-orëve, nëpër pika kontrolli të vendosura kudo në qytetet kryesore për të ndihmuar,

kontrolluar dhe këshilluar qytetarët, që të kenë kujdes për shëndetin e tyre dhe të familjarëve, si dhe të qëndrojnë nëpër banesa për të ndihmuar edhe ata vetë në mos përhapjen e këtij virusi. Stafi drejtues i Policisë Ushtarake dhe Komandantët e Kompanive përkatëse, kanë vizituar nga afër të gjitha pikat ku Policia Ushtarake ishte prezente, për të siguruar një shërbim dhe kushte sa më të mira për efektivët e tyre, si dhe për t’i uruar e përkrahur për punën e

palodhshme, që tregojnë çdo ditë”.

“Ne ju shërbejmë të gjithëve, ju na shërbeni duke qëndruar në shtëpi!”- ky ishte mesazhi sensibilizues, që efektivët në detyrë të Policisë Ushtarake përdori për tu bërë thirrje të gjithëve qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.

Sot Policia Ushtarake është e pranishme kudo, pranë çdo garnizoni ushtarak, pranë çdo ngjarje të jashtëzakonshme, pranë çdo emergjence, çdo delegacioni. Ajo është kudo duke

ndihmuar këdo dhe kjo është arsyeja pse Policinë Ushtarake e respektojnë të gjithë. Por Policia ushtarake është e pranishme edhe në misionet ndërkombëtare, ku para pak ditësh, konkretisht më 31 janar 2021, një tjetër kontingjent i Policisë Ushtarake është nisur me mision në Camp Arena në Herat të Afganistanit, në operacionin e NATO-s “Resolute Support Mission”.

Hajrie Dedaj

PËRMBYTJET NË SHKODËR

Batalioni I i Këmbësorisë, mjete lundruese në ndihmë të banorëve

Me shtimin e reshjeve dhe rritjet e nivelit të ujit në zonën e Nënshkodrës është shtuar edhe angazhimi i Forcave të Armatosura. Nga radhët e Forcave të Armatosura janë angazhuar mjetet lundruese të batalionit të mbështetjes rajonale dhe mjetet e larta të batalionit të I-rë të këmbësorisë.

Kryesisht efektivët e FA-së kanë mundësuar transportin e banorëve për nevojat e tyre të përditshme, por nuk kanë munguar rastet e evakuimit të personave nga banesat apo transporti i të sëmurëve.

Trupat e batalionit të mbështetjes rajonale transportuan me varkë një vajzë 5-vjeçare që kishte nevojë për kujdes shëndetësor, nga banesa e saj në fshatin Obot për në rrugën kryesore, ku e priste autoambulanca. Me nisjen e javës, mjetet e larta kanë transportuar për në shkollë edhe nxënësit e klasave të ulëta, të cilët mësimin e zhvillojnë fizikisht në klasa. Forcat e Armatosura gjenden



në terren në njësitë administrative Dajç dhe Ana e Malit që prej datës 8 janar dhe mbeten në gatishmëri për t’u ardhur në ndihmë banorëve.

Më herët, nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është bërë shpërndarja e ushqimit për

gjënë e gjallë në fshatrat e njësive administrative Dajç dhe Ana e Malit. Gjithashtu, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile po koordinon punën me Forcave të Armatosura, Policinë e Shtetit, prefekturën dhe bashkisë Shkodër për përballimin e situatës.

Operacioni i NATO-s “Resolute Support Mission”

Kontingjenti ushtarak niset me mision në Herat të Afganistanit

Një tjetër kontingjent i Policisë Ushtarake është nisur më 31 janar 2021, me mision në Camp Arena në Herat të Afganistanit. Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi iu ka uruar ushtarakëve mision të mbarë, ndërsa thekson se Shqipëria mbetet e vendosur për të përmbushur detyrimet e saj ndaj Aleancës.

“Kontingjenti i radhës që sapo përrollëm do të zëvendësojë kolegët e tyre të Policisë Ushtarake për të shërbyer në Camp Arena në Herat,

Peleshi: Shqipëria mbetet e vendosur për të përmbushur detyrimet e saj ndaj Aleancës dhe trupat tona janë të gatshme për të shërbyer kudo ku thirren

në misionin Resolute Support. Shqipëria mbetet e vendosur për të përmbushur detyrimet e saj ndaj Aleancës

dhe trupat tonajane të gatshme për të shërbyer kudo ku thirren”, shprehet ministri Peleshi.



NË POLIGONIN KOMBËTAR TË BIZËS

Zhvillohet stërvitja komplekse 72 orëshe e kursit të XVII-të “Komando”

Pjesë e programit është marshimi në këmbë me të gjitha pajimet personale në distancën 25 kilometra dhe sigurimi i ushqimit në natyrë (mbijetesa)

Më datë 28 janar 2021, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji i shoqëruar nga komandanti i batalionit “Komando” kolonel Edmond Doda ka inspektuar nga afër kryerjen e stërvitjes komplekse 72 orëshe të kursit të XVII-të “Komando”. Kjo stërvitje u realizua në poligonin kombëtar të Bizës dhe është një nga pjesët më të vështira të kursit “Komando” pasi ka në programin e saj marshim në këmbë me të gjitha pajimet personale në distancat 25 kilometra dhe sigurimin e ushqimit në natyrë (mbijetesa).

Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, gjatë inspektimit nga afër të kësaj stërvitjeje, përgëzoi efektivin e Instruktorëve për nivelin e lartë të përgjegjësisë dhe seriozitetit të kryerjes së këtij kursi si dhe falënderoi kursantët e kursit të XVII-të “Komando” për vendosmërinë dhe shpirtin e sakrificës që ata po tregojnë. Çdo gjë është e mundur



kur ka frymë grupi dhe një objektiv të qartë për tu arritur. “Unë shpresoj që periudha që ju po kaloni gjatë kësaj stërvitjeje, t’ju shërbejë për tu rritur edhe më tepër profesionalisht, për të treguar se kur punojmë së bashku çdo gjë është e mundur. Por, besoj gjithashtu që ju do të vazhdoni të rriteni edhe më tepër nga ana profesionale, kur të përfundoni me sukses kursin “Komando” dhe të merrni beretën e kaltër” - tha ai.

Stërvitja komplekse 72 orëshe e kursit “Komando” kishte për qëllim

testimin e aftësive ekstreme fizike dhe psikike duke i bërë të aftë kursantët të përshtaten me mjedisin që i rrethon për të kryer me sukses çdo detyrë luftarake që mund t’i ngarkohet.

Gjatë kësaj stërvitjeje u kryhen këto tema: marrshim në këmbë, taktikat e njësive të vogla, alpinizëm, prita, goditje objekti, luftim i afërt, mbijetesë, traversa topografike. E veçanta e kësaj stërvitjeje është se përveçse ngarkesës së madhe fizike dhe psikologjike janë zbatuar me sukses edhe të gjitha masat e rrepta mbrojtëse nga COVID-19.

Do të fillojnë investimet e NATO-s

Investimi i NATO-s largon turqit nga Baza Ajrore Kuçovë

Misioni i palës turke mbyllet sepse do të fillojnë punimet për rinovimin e Aeroportit të Kuçovës me investime të NATO-s

Në Bazën Ajrore Kuçovë në praninë e komandantit të bazës, major Arqile Olldashi dhe atasheut ushtarak të Republikës së Turqisë në vendin tonë, kolonel Muhammet Kelami Kablay si dhe oficerit koordinator të palës Turke në Bazën Ajrore Kuçovë e stafeve respective u zhvillua, më 30 janar 2021, ceremonia e mbarimit të misionit të palës Turke nga Baza Ajrore Kuçovë.

Major Olldashi falënderoi kolonel Kablay-n për bashkëpunimin bilateral të filluar qysh në vitin 2000 si dhe adresoi falënderimet e veçanta për palën turke për kontributin e dhënë për aerodromin dhe Bazën Ajrore Kuçovë.

Ai theksoi se, misioni po mbyllet me mirëkuptimin e të dy palëve, për shkak të fillimit të punimeve për rinovimin e Aeroportit të Kuçovës me investime të NATO-s. Komandanti i Bazës Ajrore theksoi gjithashtu se, në përfundim të këtyre punimeve dhe në varësi të nevojave që do të kemi, do të jemi të hapur përsëri për bashkëpunim bilateral në të ardhmen. Atasheu ushtarak turk vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm dhe u shpreh pozitivisht për bashkëpunimin edhe në të ardhmen. Më pas, me një solemnitat të ekipeve respective u realizua ulja e flamurit turk nga kolonel Kablay, duke vijuar kështu me dorëzimin e objektit, çelësave dhe dokumenteve përkatëse. Ceremonia u mbyll me foton e përbashkët përpara komandës së Bazës Ajrore Kuçovë.



Gjeneral brigade Arben Kingji takon efektivë të Forcës Tokësore

Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji zhvilloi një takim njohës me efektivin oficer, nëntoger, toger, kapiten që shërbejnë në repartet dhe nënrepartet e Forcës Tokësore. Komandanti i FT-së i uroi të gjithë pjesëmarrësve një vit sa më të mbarë për ta dhe familjet e tyre. Gjatë këtyre takimeve u trajtuan temat mbi disiplinën, stërvitjen, kujdesin ndaj efektivit që drejtojnë, si dhe problematikat që hasin në lidhje me punën e tyre të përditshme. Në përfundim gjeneral brigade Kingji theksoi: “Ju si oficerë do të përballeni çdo ditë me sfida të reja dhe të vjetra. E rëndësishme është të mësoni nga gabimet, të tregoheni korrekt dhe gjithmonë drejtoni me shembull personal, stërvitini vartësit tuaj, kujdesuni për ata, ruani integritetin, mirëmbani pajisjet dhe vetëzhvillohuni profesionalisht.”



Në auditoret e dy universiteteve

Shkëmbim mësimdhënie në lëndët me interes të përbashkët

Akademia e Forcave të Armatosura nënshkruan marrëveshje me Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës

Akademia e Forcave të Armatosura dhe Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, nënshkruan ditën e mërkurë, më 3 shkurt 2021, një marrëveshje me qëllim vendosjen e një kuadri institucional bashkëpunimi në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes zhvilluar në ambientet e Rektoratit të Universitetit të Durrësit, ishin të pranishëm Rektori i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura.

Marrëveshja u nënshkrua nga Rektori i Akademisë së Forcave të Armatosura Gjeneral brigade Dr. Albert Mullai dhe Rektori i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, Prof. Dr. Kseanela Sotirofski, të cilët theksuan përfitimet reciproke të dy institucioneve të Arsimit të Lartë, që rrjedhin nga vendosja dhe zhvillimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit reciprok.

Marrëveshja e nënshkruar parashikon ndër të tjera, shkëmbim të personelit akademik për mësimdhënie në lëndët e modulet me interes të përbashkët, programe studimi të përbashkëta, kualifikim të personelit akademik, nëpërmjet organizimit të seminareve, workshop-eve, konferencave shkencore, udhëheqjeve shkencore, organizimin dhe hartimin e programeve të përbashkëta, transferimin e studimeve dhe programeve sipas nevojave dhe interesit të përbashkët, bashkëpunimin për botime të përbashkëta akademike dhe periodike, shfrytëzimin e bibliotekave nga personeli akademik dhe studentët e dy institucioneve, etj. Arritja e kësaj marrëveshjeje, është një hap dhe vlerë e shtuar gjatë këtij rrugëtimi për zhvillimin e arsimit të lartë, duke nxitur bashkëpunimin ndërinstitucional në të gjitha nivelet.

Gjatë takimit u vlerësua maksimalisht statusi i veçantë i AFA si i vetmi institucion i arsimit të lartë për mbrojtjen dhe sigurinë në vendin tonë, i cili tashmë i ka hapur dyert konsolidimit të karrierës ushtarake për oficeret tanë brenda dhe jashtë FA. Një ushtri profesioniste për më tepër anëtare e NATO-s kërkon në mënyrë të detyrueshme rritjen e nivelit të arsimit të Forcave tona të Armatosura.

Universiteti i Durrësit në formën e tij moderne është themeluar në vitin 2006, por gjurmët e tij shtrihen në vitin 1380, duke e bërë një nga institucionet më të vjetër në Europë. Universiteti i Studimeve të Durrësit (latinisht: Universitas Studiorum Dyrrhachium) është krijuar rreth vitit 1380, por për shkak të sulmeve osmane është tërhequr në Zarë për të themeluar Studium Generale, ose Universitetin e Zarës, me Rektori të Parë Gjon Durrsakun.

Burime që dalin nga arkivat dhe bibliotekat e Kuvendit Françeskan dhe Kuvendit Domenikan në Dubrovnik, njoftojnë për të parin universitet në Ballkan, Universitetin e Durrësit, i themeluar nga dominikanët durrsakë të Kuvendit të Shën Maurit që vepronin në Durrës prej vitit 1224. Është i njohur fakti se profesori Gjon Durrsaku kishte vajtur në Zarë dhe atje ishte caktuar si rektori i parë i Universitetit të Zarës (1396). Në Uni-



versitetin e Zarës thuhet, shprehimisht, se "Rektori i parë ishte Gjon Durrsaku, qëkur Universiteti i Durrësit u zhvendos në Zarë për shkak të kërcënimit turk në Europën Juglindore".

Një tjetër personalitet i Universitetit të Durrësit, që po zbulohet rishtazi, ishte Ndre Durrsaku (mesi shek. XIV-13 qershor 1393). Ai njihet si doktor i shkencave teologjike (Universiteti i Bolonjës, 1380), ndërsa në vitin 1387 qe emëruar arqipeshkëv i Arqipeshkvisë së Raguzës.

Në formën e tij moderne, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, çeli

dyert për herë të parë në vitin akademik 2006-2007 me rreth një mijë studentë nga i gjithë vendi. Prej 15 vitesh në thelb të veprimtarisë së tij është përballimi me sukses i sfidave të së ardhmes bazuar në themelet e shërbimit dhe dashurisë për vendin.

Universiteti "Aleksandër Moisiu" ka 6 fakultete: Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Edukimit, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike, Fakulteti i Studimeve Profesionale dhe Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP).

AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA

Medalja "Shërbime të shquara" për kolonel Edmond Braneshi

Në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura në zbatim të masave anti-covid u organizua, ditën e martë, më 2 shkurt 2021, një ceremoni e shkurtër dhe simbolike me rastin e mbylljes së karrierës ushtarake në Forcat e Armatosura të kolonel Edmond Braneshi, si dhe daljen në pension të nënkolonelit Vladimir Bullari. Në ceremony, Gjeneral brigade Albert Mullai vlerësoi punën e bërë ndër vite nga kolonel Braneshi dhe nënkolonelit Bullari duke shërbyer me përkushtim dhe në detyra të ndryshme në Forcat e Armatosura.

"Pasioni, vullneti i duhur, pa marrë parasysh asnjë limit kohor, asnjë vështirësi, spikatën në gjithë karrierën tuaj të gjatë e të suksesshme, sidomos në fushën e mësimdhënies. Gjithë backgroundin dhe eksperiencën e vutë në funksion dhe shërbim të edukimit e aftësisimit të brezave në Forcat e Armatosura, për këtë ju jemi mirënjohës të gjithë. Ju uroj suksese dhe shëndet të plotë" - theksoi ndër të tjera Gjeneral Mullai.

Në mbyllje të ceremonisë kolonel Edmond Braneshi iu dha medalja "Për shërbime të shquara" e akorduar nga Ministri i Mbrojtjes. Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura për dy ish-ushtarakët dha certifikatë mirënjohje për kontributin dhe përkushtimin e dhënë ndër vite në Forcat e Armatosura.



FORCA DETARE-KOMPANIA E SHTABIT NË PLEPA-DURRËS

Monitorimi i projekteve dhe hartimi i strategjive të IT-së

Forca Detare, Kompania e Shtabit, Reparti Ushtarak nr. 2002, i cili ndodhet në Plepa-Durrës, ka shpallur një pozicion të lirë pune për specialist IT (dy pozicione) ku data e mbylljes së aplikimit është 6.02.2021. Specialisti për IT punon për zgjidhjen e problemeve të rrjetit të internetit dhe mirëmbajtjen e institucionit të FD-së. Suportimin në realizimin e stërvitjeve në ambjentet e FD Përgjigjet për zbatimin e politikave të përcaktuara në fushën e ndërlidhjes, sektorët e informatizimit, teknikës së informacionit dhe simeve të telekomunikacionit në Forcën Detare. Është përgjegjës për politikën e përgjithshme të implementimit dhe informatizimit të sistemeve IT, programimit, monitorimit të projekteve dhe teknikës si dhe për hartimin e strategjive të IT-së në sektorë të ndryshëm arsimorë dhe stërvitor sipas standarteve bashkëkohore të sistemeve elektronike të aplikuara në Forcën Detare. Ai ka detyra kryesore: administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të informacionit; admin-

istrimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve kompjuterike (LAN/WAN); administrimin dhe mirëmbajtjen hardware dhe software dhe gjithë komponentëve të rrjetit kompjuterik; trajnimin periodik të gjithë përdoruesve fundorë të rrjetit kompjuterik; zbatimin e masave të sigurisë teknike të informacionit; administrimin e sistemit të informacionit në KFD dhe organizimin në ngritjen tekniko-profesionale të personelit teknik të sistemit kompjuterik ne Forcat Detare. Ai mund të kryejë detyrat tjera në përshatje me nevojat e shërbimit. Puna kryhet zakonisht në zyrë në kushte normale pune. Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme: kërkesën; formularin e

aplikimit; fotokopje të kartës së identitetit; diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal; fotokopje të patentës nëse ka; dëshmi profesioni nëse ka; certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja; raport mjekësor; fotografi me përmasa 4x6, 2 copë; dëshmi penaliteti; vërtetim nga gjykata; vërtetim nga prokuroria; librezë pune; jetëshkrimin (CV). Sqarojmë se formulari i vetëdeklarimit gjendet në faqen e internetit të MM-së. Aplikuesi duhet të plotësojë disa kërkesa të përgjithshme lidhur me pozicionin e punës: të ketë shtetësinë shqiptare; të jetë jo më pak se 18 vjeç; të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar; të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin

arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara; të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore; të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi; të mos ketë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit. Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur. Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.

Qendra e Arsimit Profesional të Nënoficerëve, Zall-Herr, Tiranë

Shpallet vend i lirë pune për pozicionin: administrator-sekretar

Për të interesuarit data e mbylljes së aplikimit është 08.02.2021

Reparti Ushtarak nr. 5004, Qendra e Arsimit Profesional të Nënoficerëve-AFA, me vendodhje në Zall-Herr, Tiranë, ka shpallur vend të lirë pune, administrator-sekretar, me pagesipas VKM-së, nr.717, datë 23.6.2009, i ndryshuar. Data e fillimit të aplikimit është 25 janar 2021 dhe data e mbylljes së aplikimit është 8 shkurt 2021.

Mënyra e aplikimit:

Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën www.mod.gov.al. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t'i dërgohet Njësisë së Personelit të Strukturës që është e interesuar për rekrutimin, brenda afatit të caktuar, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën (adresa postare e repartit/strukturës përkatëse): Seksioni i Personelit Qendra e Arsimit Profesional të Nënoficerëve Zall Herr, Tiranë.

Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme: kërkesën; formularin e aplikimit; fotokopje të kartës së identitetit; diplomën e shkollës së mesme, fotokopje të patentës; dëshmi profesioni; raport mjekësor; fotografi me përmasa 4x6, 2 copë; dëshmi penaliteti; vërtetim nga gjykata; vërtetim nga prokuroria; librezë pune; jetëshkrimin (CV). Formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (linku: Baza ligjore/Akte ligjore/Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetëdeklarimit).

Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

Aplikanti i interesuar duhet të ketë shtetësinë shqiptare; të jetë jo



më pak se 18 vjeç; të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar; të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara; të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore; të mos jetë i dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi; të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

Aplikuesi duhet të plotësojë: Grada/Titulli: NC. Arsimi duhet të mesëm. Kualifikimi: Të ketë kryer kualifikim të nevojshme në fushën e administrimit. Kurse eksperiencë në punë duhet mbi 5 vjet.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin: përzgjedhjen paraprake; vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse; intervistë e strukturuar me gojë. Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Njësia e personelit të strukturës që është e interesuar për rekrutimin, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm

kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrencës. Konkurrimi me kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit të punës përfshin: vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse; vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

Vlerësimin e jetëshkrimit (CV); vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike; vlerësimin e trajnimeve; vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës. Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë: jetëshkrimi 5 pikë; arsimimi/kualifikimi 15 pikë;

trajnimi 5 pikë; eksperiencë/përvoja në punë 15 pikë. Në mbyllje të procesit të vlerësimit. Tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur. Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.

Aplikandi në fund të plotësimit të dokumentacionit të kërkuar duhet të deklarojë se të dhënat e mësipërme janë të vërteta. Ai duhet të deklarojë se nëse merret në punë dhe vërtetohet e kundërta, pranon prishjen e kontratës së punës pa paralajmërim dhe dëmshpërblim. “Deklaroj se e kam të qartë dhe jam në dijeni të së drejtës time për të kërkuar me shkrim konfirmimin që të dhënat e mia do të përdoren vetëm për qëllime seleksionimi për punësim pranë FA-së”, -pranon ai.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen për intervistën. Në rastin e përzgjedhjes së kandidatit, aplikimi dhe të gjithë dokumentat shoqërues mbeten në pronësi e FA-së. dhe nuk mund të kthehen.

Në rast se kandidati nuk përzgjidhet për vendin e lirë për të cilin aplikon, Forcat e Armatosura nuk do të ruajnë të dhënat nga aplikimi apo dokumente të tjerë shoqërues dhe ky aplikim nuk do të konsiderohet për vendet e lira që do shpallen në të ardhmen. Në këtë rast, çdo aplikant që nuk është përzgjedhur, ka të drejtë të tërheqë të dhënat e tij personale brenda një periudhe kohore prej 1 muaji nga afati i shpallur për përzgjedhjen e kandidatit për punë.



Traktati i “New START” kontribuon në stabilitetin ndërkombëtar

NATO mbështet marrëveshjen për zgjatjen e Traktatit “New START”

Deklarata e Këshillit të Atlantikut të Veriut mbi Zgjatjen e Traktatit New START” mbi kufizimin e armatimeve bërthamore

“Djemtë dhe vajzat midis moshës 20 dhe 25 u betuan sot. Edhe pse me një ndryshim në ligj kemi lejuar shërbimin ushtarak për njerëzit deri në moshën 40 vjeç, në praktikë profesioni ushtarak po bëhet tërheqës për brezin e ri, dhe jo vetëm për brezin që kishte kontakte me ushtrinë”, -tha Ministri i Mbrojtjes.



Ministri i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov

Profesioni i ushtarakut po bëhet tërheqës për brezin e ri

Në vitin 2017 kishte më pak kandidatë se pozicione të shpallura, kurse në vitin 2020 ishin gati 4 persona që aplikonin për një pozicion në ushtri

“Procesi i kapërcimit të mungesës në ushtri nuk është një veprim i vetëm. Në vitet e fundit, trende të mira janë shfaqur dhe shpresoj që ministrat e ardhshëm t'i vazhdojnë ato”. Kjo u tha gazetarëve, më 29 janar, në Karlovo nga Ministri i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov. “Sot është një ditë e lumtur për mua, sepse është e qartë se përpjekjet e udhëheqjes politike dhe ushtarake të Ministrisë së Mbrojtjes po japin rezultate. Formacionet ushtarake të Brigadës 61 kishin një nga nivelet më të larta të nën-stafit në Forcat Tokësore. Në vitin 2017, kur unë u bëra Ministër i Mbrojtjes, kishte më pak kandidatë se sa pozicionet e shpallura, kurse në vitin 2020 ishin gati 4 persona po aplikonin për një pozicion në ushtri,”-tha Ministri Karakachanov.

Si një shembull i tendencave të mira, ai tregoi ushtarakët që benë betimin. Nga 250 kandidatë që kaluan në komisionin mjekësor dhe u përcaktuan të jenë të aftë për shërbimin ushtarak, 151 u zgjedhën pas konkursit. “Kjo do të thotë që ne kemi shumë më shumë kandidatë sesa vendet e lira”, -theksoi Ministri Karakachanov.

“Djemtë dhe vajzat midis moshës 20 dhe 25 u betuan sot. Edhe pse me një ndryshim në ligj kemi lejuar shërbimin ushtarak për njerëzit deri në moshën 40 vjeç, në praktikë profesioni ushtarak po bëhet tërheqës për brezin e ri, dhe jo vetëm për brezin që kishte kontakte me ushtrinë”, -tha Ministri i Mbrojtjes.

Ai theksoi se fushata “Bëhu një Ushtar” ka dhënë rezultate dhe kujtoi se janë bërë shumë përpjekje për të



rritur pagat e ushtarakëve. “Për katër vjet me radhë, pagat e ushtarakëve janë rritur me rreth 10 përqind. Kjo nuk mjafton. Profesioni që këta djem dhe vajza të reja marrin sot është i vështirë, i përgjegjshëm dhe dinjitoz. Ai tha

në fund për gazetarët se: “Ministri i Mbrojtjes nuk është vetëm një emërim politik në një ministri”. Ai ka detyrat e tij të jetë pjesë e ushtrisë, të jetojë me problemet e saj dhe të përpiqet t'i zgjidhë ato.

KONTINGJENTET E FORCAVE TOKËSORE

Çertifikohen ushtarakët për misione në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë

Faza përfundimtare për certifikimin e një kompanie të manovrueshme për pjesëmarrje në Forcën e Stabilizimit të NATO-s në Kosovë (KFOR) dhe në operacionin ushtarak të BE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë “ALTEA” u zhvillua më 28 janar, në qendrën e trajnimit “Slivnitsa”. Në certifikim morën pjesë 200 ushtarakë me trembëdhjetë njësi me pajisje nga Komanda e Brigadës, Brigada e 2-të e Mekanizuar, Regjimenti 110 i Logjistikës dhe formacioni ushtarak 28860-Gorna Malina. Ndihmës komandanti kombëtar ishte zëvendës komandanti për mbështetjen logjistike të komandës së brigadës, majori Stanislav Tsonev, komandanti i kompanisë ishte kapiteni Petar Petkov nga batalioni i tretë i mekanizuar i komandës së brigadës. Kryetari i komisionit të certifikimit ishte koloneli Valeri Ignatov nga Komanda e Forcave të Përbashkët. Certifikimi u zhvillua në dy faza, një kontroll i dokumentit në 26 janar dhe një ushtrim special taktik dy-ditor i kompanisë në manovrën dhe elementin kombëtar të mbështetjes në 27 janar. Qëllimi kryesor i stërvitjes ishte të kontrollojë dhe vlerësojë aftësitë dhe gatishmërinë e kompanisë në manovrat, sipas CREVAL, si dhe të përmirësojë praktikën e formacioneve dhe asamblesë së kompanisë në kryerjen e detyrave. Përgatitja filloi më 16 nëntor 2020. Për gati dy muaj, ushtarakët përmirësuan njohuritë dhe aftësitë e tyre për të kryer detyra patrullimi në fushën e përgjegjësisë, inteligjencës, ngritjen e pikave të kontrollit të përkohshme dhe të përhershme, vendet e ruajtjes, ruajtja e forcave për përgjigje të shpejtë ndaj kërcënimeve (QRF), mbrojtje të forcave në trazira, etj.

RISHIKIMI STRATEGJIK I MBROJTJES DHE PROGRAMI 2032

Programi 2032 përshkruan zhvillimin e aftësive mbrojtëse të Forcave të Armatosura të Republikës së Bullgarisë

Programi për Zhvillimin e Aftësive Mbrojtëse të Forcave të Armatosura të Republikës së Bullgarisë deri në vitin 2032 përcakton kornizën strategjike dhe parametrat kryesorë të politikës së mbrojtjes dhe ndërtimit dhe mirëmbajtjes e aftësive mbrojtëse të përshtatshme për rreziqet dhe kërcënimet e Forcave të Armatosura deri në 2032.

Drafti i Programit-2032 u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave 86 të 1 Shkurtit 2021 dhe u propozua për miratim nga Asambleja Kombëtare. Dokumenti analizon mjedisin e sigurisë dhe ndikimin e tij në zhvillimin e aftësive mbrojtëse. Përcaktohet qëllimi strategjik i politikës së mbrojtjes, mbrojtja e integritetit territorial dhe mbrojtja e interesave kombëtare duke ndërtuar, ruajtur dhe përdorur aftësi të përshtatshme mbrojtëse dhe ndërtimin e Forcave të Armatosura moderne ndërvepruese me një sistem të unifikuar komandimi dhe kontrolli në kohë



pajeje dhe në kriza. Programi thekson që për zbatimin e misioneve dhe detyrave të caktuara Forcat e Armatosura do të mbajnë një numër të përgjithshëm prej jo më pak se 43,000 efektivësh, përfshirë 3,000 efektivë rezervë vullnetare. Përcaktohen aftësitë, struktura dhe sistemi për komandimin dhe kon-

trollin e Forcave të Armatosura. Nga ana funksionale, Forcat e Armatosura do të përbëhen nga një Forcë Përmbytëse dhe një Forcë Mbrojtjeje. Parashikohet krijimi i dy strukturave të reja-Komanda për komunikim dhe mbështetje të informacionit e mbrojtja kibernetike dhe Komanda

dorimi dhe mirëmbajtja, çarmatimi e planifikimi përkatës dhe sigurimi në kohë i burimeve të nevojshme financiare. Programi 2032 parashikon zhvillimin në të gjitha fushat që lidhen me Forcat e Armatosura: mbrojtja, infrastruktura e mbrojtjes, arsimit ushtarak, politika sociale, menaxhimi i burimeve njerëzore. Programi 2032 u zhvillua në bazë të rezultateve të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, i cili u zhvillua si një pjesë integrale e Rishikimit Strategjik ndër-departamental të Sistemit të Mbrojtjes së Sigurisë Kombëtare dhe Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes të zbatuar në nivelin kombëtar. Ai do të shërbejë si bazë për zhvillimin e “Planit të Zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Bullgarisë deri në 2026”, Planit pasues të Zhvillimit të Forcave të Armatosura për periudhën nga 2027 deri në 2032 dhe afatgjatë “Planit të Investimeve-Programi deri në vitin 2032.

Tragjedia e stërvitjes dimërore të 6 shkurtit 1981


Dëshmorët e Fekenit dhe orteku i malit të Meçekut

Me rastin e 40 vjetorit të rënies së 11 dëshmorëve të Fekenit. Dëshmorët e Fekenit studentë ushtarakë dhe oficerë sikurse gjithë dëshmorët e tjerë të atdheut janë vlera e përhershme e kombit


Tragjedia e stërvitjes dimërore të 6 shkurtit 1981 ishte një ngjarje e shkruar në memorien e gjithë ushtarakëve shqiptarë, por edhe më gjerë. Ishin tre oficerë dhe tetë studentë të ish-Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerave, që në kujtesën shqiptare quhen “11 dëshmorët e Meçekut”. Stërvitja dimërore masive e trupës studentore dhe pedagogjike në një ditë tepër të vështirë u kthye në një ditë që në memorien ushtarake shqiptare dhe më gjerë është quajtur “Tragjedia e Fekenit”, rrëzë malit të Meçekut. Tashmë janë të rrallë ushtarakët që e kanë jetuar ditën e tragjedisë së ushtarakëve të ish-SHLBO dhe që militojnë në FASH. Megjithatë kujtesa e shqiptarëve nuk mund të harrojë ushtarakët, studentë e pedagogë me në krye komandantin e shkollës Rustem Peçi, shefin e degës mësimore Hysen Shehu e shumë të tjerë, personalitete të shquar ushtarakë. Një unitet njerëzor, një simbolikë solidariteti ushtarak e njerëzor. Tre dekada e gjysmë kanë shkruar dhe Lapidarët e Fekenit si maja malesh lartësohen në të katër anët e Shqipërisë. Që të gjithë ranë në emër të një kauze të madhe në zemër të malit të Meçekut mbrapa malit të Dajtit në Tiranë. Kjo është dokumentuar në kujtesën e mëse 3000 pjesëmarrësve në stërvitje dimërore studentë e oficerë. Një korpus ushtarakësh në unitet vlerash njerëzore. Kështu është regjistruar tashmë jo vetëm në kujtesën e ushtarakëve ngjarja e rëndë, ku humbën jetën 11 pedagogë e studentë ushtarakë, gjatë një stërvitjeje dimërore në malin me borë mbi Dajt. Në historikun e saj të pas Luftës së Dytë Botërore, ushtria shqiptare e ka memorizuar këtë si ndodhinë më të rëndë, me numrin më të madh të viktimave e të lënduarve. Kaluan 40 vjet qysh atëherë, në opinionin publik është folur gjithmonë me rezerva për katastrofën që ndodhi gjatë atij demonstrimi, në kushte shumë të vështira të faktorëve ekstremë të natyrës sikurse janë orteqet. Madje, në periudhën kur ndodhi, autoritetet zyrtare ndaluan në mënyrë të prerë transmetimin e lajmeve në mediat e kufizuara të kohës. Fillimisht në vitet e para gjithë ngjarja ishte rrethuar me mister dhe asnjëherë nuk ka qenë përkujtuar ceremonialisht, përjashtuar takimin e përvitshëm të familjarëve të dëshmorëve studentë e oficerë në vendin e ngjarjes dhe përkujtesën e bashkëstudentëve e pedagogëve në mjediset e Akademisë Ushtarake dhe KDS-së. Vetëm pas 18 vjetëve nga rënia e tyre, në vitin 1999, të rënë e ortekut të Fekenit u shpallën “Dëshmorët të Atdheut”; ndërsa të mbijetuarit u dekoruan me medalje të ndryshme. Ndoshta Fekeni u bë në atë kohë qendër e rëndësishme e përgatitjes së luftëtarëve të ardhshëm të UÇK-së. Në librin “Dëshmorët e Atdheut”, të publikuar me rastin e 100 vjetorit të shtetit shqiptar më 2012-tën, midis rreshtave të dëshmorëve të të gjitha epokave gjejmë edhe dëshmorët e Fekenit. Ata janë shpallur dëshmorë me vendim të Komisionit shtetëror të dëshmorëve nr. 2506/2, datë 01.09.1999. Por dëshmorët studentë e pedagogë ushtarakë janë një monument i kombit, që dhanë jetën për atdheun në përleshje me stuhinë e ortekëve të dëborës. Dy kolona gjigande ushtarake në fundjanari ose në fillim të shkurtit të viteve '80 lëviznin për “stërvitje dimërore” nga Tirana e Zallherri drejt grykës së Tujanit, Zall-Bastarit dhe më tej rrugët ndaheshin: Shkolla e Bashkuar e zhvendoste aktivitetin e saj me marrshim drejt qendrës stërvitore Feken, ndërsa Shkolla e Oficerave Rezervistë zhvendosej nga Zall-Herri drejt Bizës së Martaneshit. Por kjo periudhë ishte e pamundur që mos të shoqërohej me rresht të shumta dëbore. Tre dekada e gjysmë më parë në atë ditë të ftohtë shkurti studentët e Shkollës së Lartë të Oficerëve, grupet mësimore që kishin në oficer mësimor “përgatitje fizike/ngjitje malore në terren me dëborë”, u goditën befasisht nga një ortek i fuqishëm bore që përpiu vetëm në pak sekonda 204 studentë. Ngjarja nga më shumë se tremijë dëshmitarë është treguar dhjetra e dhjetra herë në këto katër dekada. Është një tragjedi e vërtetë e pashoqe në historikun e tetë ish-shkollave ushtarake të vendit. Edhe protagonistët




Çlirim Pulaj



Nikollaq Bero



Dushan Shametaj



Aleko Gjoni

(6.2.1981-6.2.2021-me rastin e 40 vjetorit të rënies së 11 dëshmorëve të Fekenit; kushtuar Dëshmorëve të Atdheut të rënë në krye të detyrës dyzet vite më parë: komandanti i batalionit të parë të këmbësisë Dushan Fejzi Shameti (1952-1981) nga fshati Dorëz i Tepelenës, Çlirim Halil Pulaj (1945-1981), shef i planëzimit, nga Tragjasi i Vlorës; Nikollaq Naun Bero (1946-1981), pedagog taktike nga Berati; Aleko Thimio Gjoni (1958-1981), student dega prapavijë, nga fshati Nivicë Sarandë; Besnik Sulo Shehu (1958-1981), student gjitharmësh nga Picari i Gjirokastrës; Bilbil Zoto Pashaj (1958-1981), student gjitharmësh, nga fshati Kremenar, Mallakastër; Ilir Stefan Gramatikoi (1958-1981), student, dega prapavijë, nga Tirana; Bujar Masar Ago (1958-1981), student dega prapavijë, nga Vishje Tirana; Pëllumb Hysen Rrapo 1958-1981, student, dega prapavijë, nga Poshnja e Beratit; Qemal Qazim Lika (1958-1981), student gjitharmësh, nga Selba e Tiranës, Nexhip Dervish Çoba (1960-1981) student viti i dytë nga Kavaja, Durrës. Tre oficerët dhe tetë studentët e rënë në Feken janë shpallur me Vendim Nr. 2506/2 datë 1.9.1999 të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut, që është vendim i përbashkët për të njëmbëdhjetë dëshmorët e ish-Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerave “Enver Hoxha”, që ranë dhe mbetën përjetësisht më datën 6 shkurt 1981)

Zaho Golemi, Kristo Rrapo, Gjet Bushi, Behar Salillari
Ish-studentë në tragjedinë e 6.II.1981

kryesorë të organizimit shembullor, që kufizoi viktimat dhe pasojat katastrofike. Nuk ka qenë vetëm një goditje orteku, por dy orteqe njeri pas tjetrit, që nuk vinin me rrokullisje por me shkarje masive dëbore si të rreshqiste mali i tërë. Në imazhin e gjithë korpusit ushtarak pavarësisht se tashmë ajo është një ditë e largët 40 vjeçare, por dhe kaq pranë si një ditë e jashtëzakonshme e heroizmit dhe solidaritetit ushtarak shqiptar.

Një tragjedi e paralajmëruar (data 5 shkurt 1981 “binjake” e datës 6 shkurt 1981)

Programimi për stërvitjen dimërore niste që në verë. Në shtator gjithë planet dhe masat për Fekenin kanë qenë gati. Protagonistët Petrit Murzaku, Mark Mici, Bashkim Lika e shumë të tjerë të katedrës së Përgatitjes fizike por edhe specialistë nga MMP-ja dhe SHP kanë qenë udhëtruesit e ngjarjes në dekada. Në fakt katedra e Përgatitjes fizike udhëhiqte në të vërtetë gjithë trupën studentore drejt majës së Meçekut dhe krejt aktivitetit në Feken. Të gjithë ishin të bindur se kapja e lartësisë së pikës trigonometrike në majën e malit të Meçekut me lartësi 1827 metra, ishte edhe “objektivi”, ose “steka” e nivelit stërvitor në kushte dimërore krahas aktivitetit stërvitor të taktikës, qitjeve malore, zbritjes dhe ngjitjes alpinistike,


mbijetesës në guvat e dëborës, xhenios, kimisë, ndërlidhjes, topografisë në kushte fushore dimërore etj. Duke qenë dëshmitar i kësaj ngjarje sjell në kujtesë se një ditë para ngjarjes më 5 shkurt 1981 tre grupe mësimore marrshuan drejt malit të Meçekut, u “vërdallisen” nëpër Malin me Gropa dhe zbritëm drejt Staneve të Bastarës, që ngjante si të zbrisje prej Ferrit. Ishte një itinerar i përcaktuar dhe sanksionuar me program. Ndërkohë që “programi ishte ligj” dhe do të zbatohet në mënyrë të përpiktë. Mbi borën e parë që kishte ngrirë kishte rënë sërish dëborë dhe ishin krijuar dy breza dëbore, një si bazament dhe tjetri si “racion” për ne që stërviteshim në kushte ekstreme të dimrit. Vende vende era “kishte ndihmuar”, që lartësia e borës të arrinte deri në dy metra e më shumë sidomos në vende ku erërat kishin grumbulluar togje me dëborë. Gjatë gjithë itinerarit rreth 80 studentë të veshur me gjithë pajimet e ushtarit, me lopata këmbësore në dorë dhe të lidhur me litar përshkruan në një ditë nga më të egrat e viteve gjithë mjegull, erë, ngricë, e shumë dëborë. Shiu që “shkundej” nga retë nuk arrinte të zbriste në tokë sepse ngrinte në ajër e kthehej në mijëra gjilpëra akulli që na shponin fytyrën. Trupi na bindej me vështirësi, edhe pse Urdhëri mbetej urdhër. Kthenim kokën majtas e djathtas për të thyer akullin që kishte veshur pelerinën dhe qafën teksa marrshonim. Në mendjen

tonë ngelën pedagogët e apasionuar dhe të talentuar Mark Mici dhe Ramazan Zelija që ishin zotërues potencialë të kolonës. Edhe kur rirrotulloheshim malit me gropa dhe dilnim sërish tek pika trigonometrike e majës së malit të Meçekut, askush nuk e humbi toruan por me besim se do t’ja dilnim dhe në fakt në këtë “ditë motër” të ditës së 6 shkurtit 1981, ne ja dolëm. Nga T1k2b2 këmbësor ishin: Rasim Qerim Balla, Zaho Ferhat Golemi, Kristo Thoma Rrapo, Gjet Mark Bushi, Behar Halit Salillari, Avdi Bahri Larti, Aleksandër Ali Lamçe, Adem Elmaz Klefi, Agron Zenel Papdeja, Beqir Halil Halili, Dhimitër Spiro Golemi, Fadil Teme Gucaj, Flamur Xhevdet Muskaj, Ilirian Muharrem Kallëshi, Kastriot Petro Goga, Kamber Fahri Zaimaj, Luljan Voisi Taullaj, Nikollaq Stavri Gjoka, Pandeli Petro Dema, Qemal Rifan Halilaga, Simon Kozma Stambolliu, Shpëtim Mustafa Bllaca, Ilir Rapo Mema, Thoma Kristaq Xexa, Isuf Ali Villas dhe Xheladin Shaban Dashllani. Por në fakt marrshimi i kësaj dite përfundoi me sukses dhe të tre grupet mësimore u kthyen shëndoshë e mirë në qendrën stërvitore të fushimit në Feken, sipër Selitës së Malit.


Orteku si befasi përballë heroizmit masiv të studentëve

Heroizmin masiv të studentëve të


Shkollës së Lartë të Bashkuar do ta “vinte në provë” edhe rrëshqitja e ortekut nga Mali i Meçekut. Përpara kësaj ngjarjeje ajo ishte thjesht një zonë e ashpër malore ku bora binte dimrave si në “shtëpinë e vet”. “Qetësinë” ja “prishi” gjallëria dhe vrulli studentor i viteve '70-'80-të. Askush nuk besonte se një pllakë mermeri do të përjetonte një ngjarje mjaft të rëndë ku më 6 shkurt 1981, humbën jetën në krye të detyrës njëmbëdhjetë vetë, tre oficerë dhe tetë studentë të Shkollës së Bashkuar, komandanti i batalionit të parë të këmbësisë Dushan Fejzi Shameti 31 vjeçar nga fshati Dorëz i Tepelenës, Çlirim Halil Pulaj 36 vjeçar, shef i planëzimit, nga Tragjasi i Vlorës; Nikollaq Naun Bero 37 vjeçar, pedagog taktike nga Berati; Aleko Thimio Gjoni 23 vjeçar, student dega prapavijë, nga fshati Nivicë Sarandë; Besnik Sulo Shehu 23 vjeçar, student gjitharmësh nga Picari i Gjirokastrës; Bilbil Zoto Pashaj 23 vjeçar, student gjitharmësh, nga fshati Kremenar, Mallakastër; Bujar Masar Ago 23 vjeçar, student dega prapavijë, nga Tirana; Ilir Stefan Gramatikoi 23 vjeçar, student, dega prapavijë, nga Tirana; Pëllumb Hysen Rrapo 23 vjeçar, student, dega prapavijë, nga Berati; Qemal Qazim Lika 23 vjeçar, student gjitharmësh, nga Tirana, Nexhip Dervish Çoba 21 vjeçar student viti i dytë nga Kavaja. Ndërsa mbetën të të dëmtuar më rëndë Përparim Velu, student, dega prapavijë nga Saranda dhe Luan Muça student gjitharmësh, nga Peshkopia. Nga ngjarja kishte edhe rreth 70-80 studentë e oficerë që u plagosën rëndë ndërkohë që të plagosurit në total ishin rreth 360-400 studentë e oficerë. Dimri shumë i ashpër, koha me shi e dëborë, ka qenë e parapëlqyer për stërvitjet dimërore, ndërkohë që edhe një ekip inspektimi nga Ministria e Mbrojtjes Popullore ka qenë në fushim. Natën e 5 shkurtit duke u gdhirë 6 shkurti një shi i ftohtë me flokë dëbore trazuar, ra përgjatë gjithë natës dhe mbi dëborën që kishte rënë më përpara ra një shtresë e re dëbore, e cila dukej sikur “flinte”, por edhe në gatishmëri për të rrëshqitur. Kjo e vështirësoi shumë lëvizjen tonë për ngjitjen në malin hije rëndë të Meçekut. Mëngjesi i 6 shkurtit 1981, i ngjante një minxyre. Kohë e mot i pabesueshëm dhe i pabesë. Rreshtimi i orës 8-të e më tej nga fushimi nën drejtimin e pedagogëve bëhej



Besnik Shehu




Qemal Lika



Nexhip Çoba



Bilbil Pashaj



Bujar Ago

shpërndarja për stërvitje. Tek “ngjitja malore me teknika të alpinizmit në kushte të vështira të terrenit e të motit”, ishte edhe vëmendja më e madhe e strukturave. Kolona gjarpëroi “qafën e topave”, ngjiti rrugën automobilistike me gjashtë toga me 204 studentë, një kolonë me rreth gjysëm kilometri e gjatë e ngjeshur. Në krye ishte pedagog Mark Mici pedagogu tropojan me përvojë të gjatë pune, shumë i aftë nga ana profesionale, me një përgatitje fizike të lakmueshme. Instruktazi, teknikat e lëvizjes, masat për plotësimin me sukses të detyrës së alpinizmit, përdorimin i kazmës, mbajtja e litarit kolektiv, komunikimi etj. T1k1b2, i ndoqi me sy e rreshtuar si togë e gatshme atë ditë tragjedie. Pjerrësia e shpatit të malit e vështirësonte shumë ngjitjen. Por porosinë e drejtuesve të ngjitjes “kujdes shokun!”, “Ndhmoni njeri-tjetrin!”, “Mos krijoni shkëputje!”, “Shkelni në gjurmët e shokut!”, “Mos lësho litarin për asnjë cast!” etj., ishin urdhëruese për cilindo pjeshtar të kolonës. Togat e këmbësorisë në krye dhe më tej toga e prapavijës, ndërlihdjes, AKA-së. Marrshimi vijonte i sigurtë përmes pyllit me ahishte. Kolona doli tek “tre pemët e vetmuara”, që ishin si pikë orientimi për kalimin e studentëve. Qetësi. Fëshfërimë degësh e shkurresh. Fjalët e studentëve i merrte era, era e ftohtë që u thante veshët si dhe fishkëllente pa pushim, si të njoftonte kobin e asaj dite. Kur “koka” e kolonës ishte rreth 250-300 metra nga maja e malit si dhe më shumë se gjysma e kolonës kishte dalë nga pylli në pjesën e zhveshur të malit por të mbuluar nga bardhësia e dëborës. Ndërkohë grupi i sigurimit të kolonës, devijoi majtas rreth 80-100 metra. Por ndërkohë gjurmët e studentëve prenë njëherazi edhe dëborën e re që ishte mbi dëborën e akullit. Kështu shtresa e dëborës që nga maja u shkëput rrufeshëm dhe në fare pak sekonda goditi gjithë kolonën e marrshimit. Gjithë faqja e malit me dëborë në gjithë gjerësinë rrëmbeu me vete çfarë gjeti përpara, duke u shndëruar kështu në një grumbull dëborë të fuqishëm dhe të rrezikshëm. Orteku mori përpara studentë e pedagogë, shkarpa, dëgë, trungje, gjithëcka. Kishte filluar “përlëshja” me dëborën për të shpëtuar jetën e tyre dhe jetën e shokëve. Uturima e dëborës zbriti shpatit të malit dhe u bashkua me thirrjet e studentëve që kërkonin shokët. Sigurimi i kolonës nuk kishte më vlerë i lidhur, por fati i ndihmoi të ndaleshin në një grumbull shkurresh e pemësh. Litarët kolektivë dhe çelësat e sigurisë nuk kryenin më punë. Fenomeni i ekstremit natyror i tipit “ortek” kishte ligjësitë e veta. Mbështetja humanitare kishte dalë në plan të parë. Ishte më shumë se një gjëmë. Nga protagonistët e ngjarjes kemi shkëputur të dhëna nga Bashkim Lika (ish-pedagog i përgatitjes fizike) që atë ditë udhëhiqte marshimin e datën 6 shkurt 1981, në ditën e tragjedisë: “Orteku i parë rrëmbeu më shumë se gjysmën e kolonës me një goditje të befasishme. Ajo ishte një gjëmë. Orteku rrëmbeu, sa hap e mbyll sytë, gati tërë kolonën e gjatë të studentëve që i ngjiteshin Meçekut, në atë fillimshkurti të acartë. Ishte demonstrim alpinistik mbi majmëalet e ngarkuara me dëborë...Ishte mëngjesi i 6 shkurtit i vitit 1981. Ishte një ditë e ftohtë dhe me erë të rrëmbyeshme. 12 grupe mësimore (toga) me 204 studentë gjithësej, atë ditë do të përpunonim ngjitjen malore me elementë të alpinizmit, në një terren të thyer dhe me trashësi të madhe bore. Nisja ishte e zakonshme, si në të gjitha ditët e tjera. Kolonën e marshimit e udhëhiqte, si gjithnjë në të tilla stërvitje, pedagogu i talentuar Mark Mici, i cili me trupin e lehtë dhe kondicionin e lartë fizik, printe gjithë optimizim dhe energji. Për çdo rast nevojë, ishin 15 pushkatarë të vendosur

5 në krye të kolonës, 5 në mes dhe 5 të tjerë në fund të saj. Ata garantonin jetën e shokëve nga çdo e papritur gjatë marshimit. Kështu veprohej gjithnjë në demonstrime që bënim jashtë fushimit e sidomos gjatë stërvitjeve në lartësi dhe në pyje, ku edhe gjatë verës nuk ka jetë. Na kishte ndodhur jo rrallë përballja me kafshë të egërsuara, madje edhe me arinj të uritur. Gjithsesi, vështirësive të kësaj natyre ua kishim marrë dorën dhe u paraprinim me masa sigurie të veçanta. Kur kreu i kolonës arriti tek vendi i quajtur “Tre pemët e vetmuara”, siç ishte koduar në hartë, na rrëshqiti nën këmbë me një shpejtësi të jashtëzakonshme e tërë faqja e malit, mbështjellë me një trashësi të madhe dëborë. Ishte një goditje e beftë dhe e fuqishme, që ushtoi me një gjënim shurdhues dhe rrëmbeu me vete sa hap e mbyll sytë gati gjysmën e kolonës. Për pak sekonda shokët humbën nën trashësinë e dëborës. Një mal i madh dëborë rrëshqiste me shpejtësi të rrufeshme shpatit të thepisur. Panik dhe ulërima, thirrje dhe krisma vijuan për pak çaste. Ata që mundën të dalin nga masivet e bardha të borës bërtisnin e kërkonin ndihmë, për të shpëtuar shokët e mbetur në rrënojat e ortekut, që kishte gëlltitur gjysmën e efektivit. Goditja e parë ishte vala e parë që çoi studentë e oficerë mes masivit të borës me trupa të gjymtuar, pajisje të shpërndara poshtë e lart, një gjëmë e vërtetë, pa mundësi bilanci të plotë mbi humbjet, gjymtime, dhe ata që prisnin me shpresë nën rrënojat e bardha të ortekut të dëborës.


Orteku i dytë më i forti, më i tmerrshmi dhe më tragjiku

Sapo në komandë të Shkollës së Bashkuar (të transferuar këto ditë në Feken), në qendër të fushimit ishte dhënë kushttrimi. Pritej nga momenti në moment të vinin shokët e tjerë, për të kërkuar të humburit dhe për të transportuar të gjymtuarit. Nga Shtabi i Përgjithshëm, kishin ardhur edhe ushtarakë madhorë për të inspektuar demonstrimet stërvitore në kushtet e vështira të motit dhe terrenit. Fakt është se rreth dy orë pas ortekut të parë ra edhe orteku i dytë që ishte më i fuqishëm, më i tmerrshëm dhe më tragjik. Në vendin e ngjarjes ishte grumbulluar një numër i konsiderueshëm studentësh nga efektivit i shkollës. Fill pas dhënies së sinjalit të kushttrimit nga togat që bënin ngjitjen malore ndër të parët që mbërritën aty ishin toga e gatshme e fushimit t1k2b2 e drejtuar nga Rasim Balla. Bashkë me togën e gatshme me makinën e gatshme u nis edhe Vasil Nathanaili dhe Oficeri i degës së planizimit Çlirim Pulaj, sot “dëshmor i atdheut”. Makina nuk mund të ngjitej më tej prej rrugës me akull si dhe dëborë të ngjeshur të bërë si akull. Kështu që pas përpjekjeve makina ngeli disa metra mbi “qafën e Topave”. Toga jonë e gatshme, u nis me këmbë, ndërkohë që drejt rrugës këmbësore, direkt mbi godinat e Fekenit, ishte nisur i pari komandanti i batalionit Dushan Shamenti. Mbërritja ishte e shpejtë dhe menjëherë filloi puna. Prezenca ishte masive si Petrit Murzaku, Abaz Çipi, Sali Xhakupi, Nikollaq Bero, Luftar Guri, Myzafer Kambo, etj, etj. Të gjithë kërkonin të ndihmonin të dëmtuarit dhe kërkonin trupat e shokëve nën rrënojat e dëborës. Goditja e furishme dhe në mënyrë të papritur shkaktoi edhe më shumë viktima. Kacafytja me përbindëshin e bardhë, pamjet rrëqethëse, zërat lemeritës të studentëve, nga plagët e shumta, dhimbja për shokët e vdekur, kishin sjellë një gjendje ankthi, një dramë të jashtëzakonshme. Dy orë gërmime në dëborë. Stërvitja u ndërpre dhe mali kishte ndalur frymën. Në këtë operacion për të



Pëllumb Rrapo

shpëtuar shokët, do të mbeteshin pishtarë të humanizmit dhe solidaritetit ushtarak. Befasia, tronditja, llahtaria e ditës së zezë të tragjedisë u mbyll pas tre ditësh, kur e gjithë shkolla po kërkonte viktimën e fundit të ortekut që e kishte rrëmbyer në thonjtë e vdekjes. Por në këtë rast pati dhe shumë të tjerë të gjymtuar me plagë të rënda. Të goditur më rëndë ishin Përparim Velu nga Saranda dhe Luan Muça nga Peshkopia. Media e kohës nuk mund të fliste asnjë fjalë për këtë tragjedi, asnjë botim a njoftim. Edhe transportimi i trupave të viktimave ishte bërë në muzgon e natës në kushtet e mungesës së plotë të kontaktit me qytetarët e tjerë. Urdhëri i Mehmet Shehut ishte që studentët e vdekur të visheshin me uniformën e ceremonialit të oficerit si dhe pushteti vendor kishte marrë masa ekstreme të kujdesit dhe vigjilencës në gjithë ceremonitë mortore. Ata ishin studentë e oficerë me shpirt, të ri që e kishin të shenjtë dashurinë për atdheun dhe për shokët deri në sakrificën supreme. Të japësh jetën për shokun, nuk ka asnjë mënyrë tjetër më dëshmuar për të vërtetuar sinqeritetin e dashurisë njerëzore. Ishte një meritë e shkollës, burim i pashtershëm përvojë për arsimimin ushtarak. Për përjetësimin e veprës së dëshmorëve, është ngritur një Memorial, një lapidar në lulishten kryesore të Garnizonit Ushtarak “Skënderbej”, është vendosur në një copë shkëmbi të madh nga Mali i Meçekut. Në atë copëz shkëmbi memorialistik është vendosur një pllakë përkujtimore me emrat e 11 dëshmorëve. Dhe mbi të një shqiponjë e bardhë si shpirti i bardhë i dëshmorëve ushtarakë, që qëndron përjetësisht në roje të tyre dhe duket se ka dalë nga zemra e flamurit tonë kombëtar. Shkrime të shumtë, proza, poezi e poema dhe një film dokumentar “Orteku”, veçanërisht në këto dy dekadat e fundit që sjellin shpirtin atdhetar e human, nga dëshira dhe pasioni për të përjetësuar veprën dhe emrin e madh të dëshmorit të Atdheut. Kadri shamenti ka publikuar librin “Bijtë e pavdekshëm të Shkollës së Bashkuar të Oficerave”, një përshkrim njerëzor të natyrores, ortek bore të malit të Meçekut. Vala e dytë e ortekut, kur shkuan për të shpëtuar shokët, që i zuri vala e parë e ortekut, ku u shpaloën në mënyrë madhështore cilësitë e larta morale e humane të oficerëve dhe studentëve ushtarakë. Peshja e rëndë e dhimbjes për humbjen e shokëve tanë, ishte dhe është e madhe. Mobilizimi studentor, i komandës së Shkollës si dhe strukturave të shtetit ishte i madh. Orteku nuk priste për porosi dhe amanete, por preu në besë 11 jetë njerëzore. Dashuria njerëzore u shpalo në këtë ditë tragjike, kur të plagosurit rëndë u transportuan në “Qafën e Patates”, ku erërat e forta nuk lejonin



Bujar Ago

uljen e helikopterëve të ardhur nga Farka. Guximi i pilotëve bëri që pranë efektivit të ishte vetë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Veli Llakaj, me staf mjekësor nga Spitali Ushtarak, të cilët filluan mjekimet në kushte fushore. Përparësi ishte shpëtimi i sa më shumë jetësh njerëzore prandaj edhe u fillua me të aksidentuarit më rëndë, që luftonin për jetën. Fakt është se stafi drejtues i Shkollës së Bashkuar të drejtuar nga komandanti Rustem Peçi sapo u informua për ngjarjen, vlerësoi në mënyrë të rrufeshme situatën e rëndë, bëri organizimin e menjëhershëm të të gjithë trupës komanduese, pedagogjike dhe studentore për të ndihmuar të dëmtuarit nga goditja e dy orteqeve. Gjithë komanduesit oficerë, pedagogë, studentë ndërprejnë stërvitjen dhe nga të gjitha drejtimit, nga fushimi, nga “Qafa e shefave”, nga “Shkëmbi i Selitës” dhe “Qafa e vdekjes”, “Qafa Isuf Plloçi” u gjendën në mënyrë të menjëhershme, në ndihmë të dëmtuarve nga orteku në faqen e malit të Meçekut nga “tre pemët e vetmuara” e deri në rrugën automobilistike që lidhte “Qafa Isuf Plloçi” me Fekenin. Por pavarësisht masave të menjëhershme dhe që në fakt u shpëtuan shumë jetë njerëzore, përsëri në shpatin e pjerrët të Meçekut ngelën dhe dhanë shpirt njëmbëdhjetë dëshmorë. Sa herë që do të kujtohen dëshmorët e Fekenit, nuk janë studiuesit e historiografisë ushtarake, por në një front me ta janë të përbashkuar edhe ushtarakë e ish-ushtarakë, që shkruanin dhe shkruajnë me zemër për këtë ngjarje që la gjurmë që nuk shlyhen edhe pas katër dekadash dhe nuk do të shlyhen për dhjetra e dhjetra dekada që do të vijjnë. Prandaj për dëshmorët e Fekenit do të përkujtohen dhe shkruhet edhe në të ardhmen, sepse kush kujtohet nuk harrohet!

Dëshmorët e Fekenit-bashkë me ne, në çdo apel

Njëmbëdhjetë Dëshmorët e Fekenit, komandantë, pedagogë e studentë të ish-Shkollës së Bashkuar të Oficerëve, sot FMS/AFA, ranë në stërvitje dimërore nbi kazermën e stërvitjes dimërore të Fekenit duke u ngjitur në Meçek. Ushtarakët dhanë jetën për të shpëtuar jetë me një akt sublim, një simbolikë e papërsëritshme e formimit të lidershipit për të ardhmen ushtarake shqiptare. Një shëmbëlltyrë motivimi, një forcë karakteri, me të harruarin “shembullin personal” në kufijtë e vetmohimit. Ka qenë një forcë e brendshme e njerëzve nën uniformë të rreshtuar në armatën me palcë kombëtare, në armatën që diti të mposhtë e triumfojë mbi kushtet më ekstreme atmosferike të shkurtit të vitit 1981. Edhe sot motivi ushtarak i

strukturave të Forcave të Armatosura është njësh me detyrimin madhor në përmbyshje të misionit, në përballje me emergjencën civile të shkakuar nga kushtet e rënda atmosferike. Kjo është e vërtetueshme përditë sepse edhe sot Forcat e Armatosura mbajnë ndezur e forcojmë brez pas brezi procesin e arsimimit dhe trainimit ushtarak. Stafeta vijon të pasohet nga brezi në brez dhe po kështu edhe historia e njëmbëdhjetë dëshmorëve. Kujtimi i të rënëve dëshmorë në Feken është frymëzim, një akt heroik e sublim, një “stacion” i rëndësishëm i historisë ushtarake, një stacion përjetësie, por dhe pjesë e pandarë e jetës së përditshme ushtarake. Në çdo apel ushtarak nuk mungojnë ata që shkruan histori sublime më 6 shkurt të vitit 1981: “Komandant Dushan Shamenti, Shefi i Planizimit Çlirim Pulaj, Pedagog Nikollaq Bero si dhe studentët Aleko Gjoni, Besnik Shehu, Bilbil Pashaj, Bujar Ago, Qemal Lika, Pëllumb Rrapo, Ilir Gramatiko, Nexhip Çopa”.

Emërndriturit dëshmor – shokët tanë të barikadës së sigurisë dhe mbrojtjes

Dëshmorët e Fekenit studentë ushtarakë dhe oficerë sikurse gjithë dëshmorët e tjerë të atdheut janë vlera e përhershme e kombit. Ata ranë për atdheun, me ideal të pastër me solidaritet njerëzor, me unitet ushtarak, prandaj mirënjohja për gjakun e derdhur është nderim në përjetësi, për aktin sublim të dhënies së jetës për atdhe. “Dëshmor” është një emër i ndritur për popuj e kombe kudo në botë. Kështu janë dhe dëshmorët ushtarakë të Fekenit, për kombin shqiptar. Dëshmorët nuk janë numra e shifra, por vlera hyjnore, respekti, mirënjohjeje, kujtimi. Ata nuk janë emra, varre, lapidarë, memoriale, por vlera të spikatura kombëtare përjetësisht të nderuar dhe respektuar në përjetësi. Ata janë pasuri e kombit që lidhin të djeshmen me të sotmen, janë trashëgimia e ndërgjegjes kombëtare, janë vlerat dhe virtytet reale të familjeve krenare, janë ajo materie e ndërgjegjes së kombit që lidhin të djeshmen me të sotmen kur në gojën e popullit është materializuar me shprehjen tashmë të profetizuar se, “pa të shkruar nuk ka të ardhme”. Volteri thoshte se, “Trimëria është produkt i qartësisë”, që kupton qartësinë e vetflijimit për kauzën e kombit. Nga antikiteti latin vjen thënia proverbiale: “Gjaku është fara e lirisë”. Gjaku i dëshmorëve të Fekenit që ranë në zemër të malit të Meçekut, ishte sakrifica sublime për sigurinë dhe mbrojtjen e popullit, dinjitet për brezat e rinj ushtarakë të Forcave të Armatosura. Ne ish-studentët që i përjetuam ato ditë tragjike, u “certifikuam” në kudhrën e mbijetesës dhe përkujtojmë sot pas katër dekadash masat e marra nga Ministria e Mbrojtjes dhe komanda e shkollës në përcjelljen e të rënëve pranë familjeve të tyre, për organizimin e ceremonive mortore, për t’iu dhënë lamtumirën e fundit shokëve tanë. Dhimbjes në përcjelljen e të rënëve në spitalin ushtarak, ju bashkua Ministri i Mbrojtjes Kadri Hazbiu dhe më tej tek të plagosurit e Fekenit erdhi edhe vetë ish-kryeministri më jetëgjatë i vendit Mehmet Shehu. Një lot ka ngelur i ngrirë në historikun e Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerave, një lot që nuk do të shkrijë kurrë në historikun e arsimimit ushtarak shqiptar, një lot që përkujton trimërinë dhe humanizmin studentor ushtarak si burim frymëzimi për gjithë brezat e shkollës ushtarake shqiptare.



PËRMBYTJET NË SHKODËR

Batalioni i I-rë i Këmbësorisë, mjete lundruese në ndihmë të banorëve

Shirat të shoqëruara me permbytje në zonën e Nënshkodrës kanë bërë të domosdoshme vendosjen në funksionim të mjeteve lundruese të Forcave të Armatosura. U angazhuan mjete lundruese të Batalionit të Mbështetjes Rajonale dhe Batalionit të I-rë të Këmbësorisë. U mundësua transporti i banorëve për nevojat e tyre të përditshme, por edhe evakuimi i personave nga banesat apo transporti i të sëmurëve. U transportua me varkë një vajzë 5-vjeçare që kishte nevojë për kujdes shëndetësor, nga banesa e saj në fshatin Obot për në rrugën kryesore, ku e priste autoambulanca. Ndërsa janë transportuar për në shkollë edhe nxënësit e klasave të ulëta, të cilët mësimin e zhvillojnë fizikisht në klasa. Gjithashtu është bërë shpërndarja e ushqimit për gjënë e gjallë në fshatrat e njësive administrative Dajç dhe Ana e Malit. Forcat e Armatosura gjenden në terren në njësitë administrative Dajç dhe Ana e Malit që prej datës 8 janar dhe mbeten në gatishmëri për t'u ardhur në ndihmë banorëve.

